



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2745 Prot. datë 18.5.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 8429/1 Prot. datë 19.5.2020

U R D H Ë R

Nr. 114, datë 18.5 2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË POSAÇME PËR ZHVILLIMIN E MATURËS
SHTETËRORE 2020 NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR SHKAK TË
GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E
COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 26, 51 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 18/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, të vendimit nr. 243, datë 24.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e “Rregullore së posaçme për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për çështje që nuk trajtohen nga kjo rregullore e posaçme, do të zbatohet rregullorja e miratuar me urdhrin nr. 537, datë 08.11.2019, “Për miratimin e Rregullore së posaçme për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Sekretari i Përgjithshëm i i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Besa SHAHINI



MINISTËR
Anila DENAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2745/11 Prot.

Tiranë, më 18.05.2020

RREGULLORE

E POSAÇME PËR ZHVILLIMIN E MATURËS SHTETËRORE 2020 NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR SHKAK TË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19

1. Matura Shtetërore (MSH) 2020 dhe Matura Shtetërore Profesionale 2020 do të zhvillohet gjatë muajit qershor, në datat e përcaktuara me udhëzimin nr. 28, datë 12.12.2019 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2020”.
2. Maturanti/kandidati duhet të respektojë rregullat e distancimit fizik dhe të higjienës, në zbatim të urdhrimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nr. 289, datë 4.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit “Për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore””.
3. Të gjithë personat e përfshirë në administrimin e procesit të Maturës Shtetërore, të kenë detyrimisht maskë dhe doreza gjatë gjithë procesit dhe të respektojnë distancimin fizik në zbatim të urdhrimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 289, datë 4.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit “Për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore””.
4. Programet lëndore orientuese të rishikuara për provimet e Maturës Shtetërore dhe për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale, duke përjashtuar pjesën e programit që është zhvilluar online, janë hartuar dhe publikuar në faqet zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).
5. Provimet e detyruara dhe provimi me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë. Provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2020 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë.

6. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) harton testet e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale, bazuar në programet orientuese të rishikuara të Maturës Shtetërore 2020.
7. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore arsimore (ZVA) trajnojnë online dhe pajisin me manualin e detyrave dhe përgjegjësive Përgjegjësit e Administrimit të Provimit (PAP), Administratorët e Provimit (AP) dhe Përgjegjësit e Katit (PK), të cilët nënshkruajnë deklaratën e përbushjes së detyrave dhe përgjegjësive gjatë administrimit të Maturës Shtetërore.
8. Komiteti i Maturës Shtetërore trajnon online përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
9. Komisioni i Maturës Shtetërore në Zyrën Vendore Arsimore dërgon në njësitë e pushtetit vendor listën e shkollave ku do të zhvillohen provime të Maturës Shtetërore dhe ato kryejnë dezinfektimin këtyre shkollave.
10. Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH) përgatit/kontrollon mjediset e provimeve 24 orë përpara çdo provimi, duke respektuar rregullat e higjienës dhe distancimin fizik, sipas protokollit të MSHMS-së.
11. Drejtori i shkollës konfirmon në ZVA, një ditë para ditës së provimit, se mjedisi përbush kushtet higjieno-sanitare dhe të distancimit fizik. Nëse mjedisi i provimit është në kundërshtim me rregulloren e Maturës Shtetërore dhe protokollin e MSHMS-së për drejtorin e shkollës do të merren masa administrative sipas përcaktimeve të Rregullores së Maturës Shtetërore 2020.
12. Mjediset ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të dezinfektuara, sipas protokollit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
13. Për çdo 10-15 maturantë/kandidatë caktohet një Administrator Provimi.
14. Maturantët/kandidatët hyjnë në qendrën e provimit në radhë një nga një, me largësi 1.5 -2 metra nga njëri-tjetri, sipas orareve të hartuara nga KSHMSH duke respektuar që deri gjysmë orë para fillimit të provimit të gjithë maturantët të jenë sistemuar sipas klasave dhe tavolinave personale.
15. Staf i mjekësor i shkollës (mjeku/infermierja e shkollës), nëse ka, apo personeli i shkollës i caktuar nga drejtori, kryen për çdo maturant/kandidat procedurën si më poshtë:
 - Mat temperaturën në ballë me termometër digjital.
 - Spërkat solucion dezinfektues me përmbajtje 70% alkooli në duart e nxënësve.
 - Kontrollon nëse çdo nxënës është i pajisur me maskë dhe doreza.

- Pajis nxënësit me maskë dhe doreza nëse nuk i disponojnë.

16. Administratori i Provimit shpërndan dhe grumbullon për çdo maturant vetëm një test dhe fletë-përgjigje të personalizuar, për të gjitha profilet bazuar në listën e pjesëmarrjes të dërguar nga QSHA. Administratori i Provimit siguron se çdo maturant që dorëzon testin dhe fletë-përgjigjen duhet t'i ketë firmosur ato.
17. Maturanti/kandidati pasi merr testin dhe fletë-përgjigjen nga AP, kontrollon që ato janë me emrin e tij dhe i nënshkruan. Gjithashtu, kontrollon gjendjen fizike të testit (është i palexueshëm, mungon ndonjë faqe etj.). Nëse vërehen parregullsi kërkon test tjetër nga AP, duke plotësuar një deklaratë për marrjen e testit, duke shënuar edhe emrin në test me shkrimin e tij.
18. Testi është i ndërtuar vetëm me pyetje me alternativa.
19. Rregullat e plotësimit të testit nga maturanti/kandidati janë si vijon:
 - a) duhet të përdorë stilolaps blu ose të zi;
 - b) duhet të mbushë me stilolaps për secilën pyetje rrethin që përfaqëson alternativën që e mendon si të saktë;
 - c) nëse për një pyetje ka mbushur dy rrahë, përgjigjja për këtë pyetje do të konsiderohet e pavlefshme dhe do të vlerësohet me 0 pikë;
 - d) nëse për një pyetje ka qarkuar alternativën e saktë në test, por nuk ka mbushur rrethin përkatës në tabelat e fletë-përgjigjes, ajo pyetje do të vlerësohet me 0 pikë;
 - e) nëse për një pyetje nuk ka mbushur asnjë rreth, ajo pyetje do të vlerësohet me 0 pikë;
 - f) nuk duhet të përdorë korrektorë në tabelat e fletë-përgjigjes, pasi alternativat që janë mbushur duke përdorur korrektor nuk vlerësohen nga sistemi elektronik i vlerësimit.
20. Vlerësimi i testeve realizohet në qendra vlerësimi me mjedise të përshtatshme dhe të sigurta, të përzgjedhura nga QSHA. Vlerësimi i testeve kryhet nëpërmjet teknologjisë digjitale.

MINISTRI

Besa SHAHINI

